



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Shtator 2021

Nr. 451

VENDIM

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 21.09.2021 në përmbushje të vendimit nr. 108, datë 26.7.2021, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi riçeli hetimin administrativ të çështjes që u përket:

Kërkues: Organizata “Qëndresa Qytetare”

Ndaj: Z. Alfred Muharremi
Bashkisë Tiranë
Bibliotekës “Misto Treska”
Partisë Socialiste e Shqipërisë

Objekti i ankimit: Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambjentet e bibliotekës “Misto Treska”

Baza ligjore: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, dhe neni 91, të ligjit nr. 10019, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

I. Rrethanat e faktit

- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në portalin e denoncimeve, më datë 17.03.2021, është raportuar nga Organizata “Qëndresa Qytetare”, denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2343,



Data: 21 Shtator 2021
Nr. 451

Riçelje e hetimit administrativ ndaj kërkesës ankimore nr. 61 datë 22.7.2021 depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

ndaj kandidatit për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Alfred Muharremi, me pretendimin se ka zhvilluar një takim mbështetës të forcës politike që përfaqëson, në ambientet e bibliotekës së qytetit Tiranë, “Misto Treska”, e cila është hapësirë publike, pronë e Bashkisë Tiranë.

- Në cilësinë e provës Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka vendosur në dispozicion dy link-e të rrjetit social facebook, në të cilin sipas saj, gjenden provat e aktivitetit.

Link:

<https://www.facebook.com/ErionVeliaj/photos/pcb.10159313175761926/10159313169706926/>

<https://www.facebook.com/ErionVeliaj/videos/461285911978435>

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmoi se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qëndresa Qytetare” përbënin indicie të besueshme për fillimin e procedurës administrative.
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 3406 prot., datë 07.04.2021, i ka kërkuar Bashkisë Tiranë informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e aktivitetit të kandidatit për deputet z. Alfred Muharremi, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës.
- Me shkresën nr. 1444/1 prot., datë 14.5.2021, administratorja e njësisë administrative bën me dije se, në bibliotekën “Misto Treska”, e cila ndodhet në administrimin e kësaj njësie, zhvillon shpesh evenimente dhe aktivitete të karakterit social, kulturor dhe informues për banorët e njësisë dhe më gjerë dhe në asnjë rast nën menaxhimin dhe monitorimin e tyre nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i karakterit zgjedhor, kjo dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 35 datë 29.3.2018 “Bibliotekat e lagjeve si qendra multifunksionale”.
- Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në çmim të fakteve dhe provave të disponuara nga palët në shqyrtim administrativ, me vendimin nr. 427 datë 16.7.2021, vendosi përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Bashkisë Tiranë, për arsye se nuk konstatohen elementë të shkeljes së dispozitave të nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2021, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pasi lidhur me sa parashikon neni 3, pika 1.3, shkronja “c” e vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, për sa i përket vënies në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, duhet që këto asete të vihen në dispozicion për qëllime zgjedhore.
- Më datë 22.07.2021, Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka paraqitur kërkesën ankimore nr. 61 në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr. 427, datë 05.07.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.
- Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 108, datë 26.07.2021, vendosi:



Data: 21 Shtator 2021

Nr. 451

Riçelje e hetimit administrativ ndaj kërkesës ankimore nr. 61 datë 22.7.2021 depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 108, datë 26.7.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Riçeljen e hetimit administrativ të plotë dhe të gjithëanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative, duke u garantuar palëve, subjekteve të kallëzuara në denoncimin në fjalë (kandidatit për deputet dhe bashkisë Tiranë) të drejta të plota në procesin administrativ.

II. Riçelja e hetimit administrativ

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në respektim të vendimit të KAS nr. 108, datë 26.07.2021, ditën e premte, më datë 17.09.2021, ora 12:00, në përputhje me përcaktimet e nenit 47 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, riçeli hetimin administrativ të plotë e të gjithanshëm për të garantuar të drejtat e palëve në proces administrativ, duke zhvillua një seancë dëgjimore, në të cilën u thirrën: Organizata “Qëndresa Qytetare”, z. Alfred Muharremi, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Bashkia Tiranë, përfaqësues të bibliotekës “Misto Treska” si dhe subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- Në seancën dëgjimore i pranishëm ishte përfaqësuesi i Organizatës “Qëndresa Qytetare” si dhe kandidati për deputet, z. Alfred Muharremi. Palët e tjera nuk u paraqitën.
- Përfaqësuesi ligjor i Organizatës “Qëndresa Qytetare”, rikonfirmoi pretendimet e tij për përdorimin e bibliotekës “Misto Treska”, duke pretenduar se është shkelur haptazi Kodi Zgjedhor si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2012, i Komisionit Rregullator, sipas të cilit ndalohej përdorimi i aseteve publike për aktivitete të fushatës elektorale. Sipas tij, bibliotekat e Tiranës është nën administrimin e bashkisë Tiranë dhe janë asete publike të administruara dhe në pronësi të Bashkisë Tiranë. Është provuar nëpërmjet pamjeve filmike dhe provave fotografike, të marra nga rrjeti social facebook, se kjo bibliotekë është vënë në dispozicion të kandidatit për deputet për kryerjen e aktivitetit elektorale.
- Në shpjegimet e dhënë në seancë dëgjimore, kandidati për deputet z. Alfred Muharremi, pohon se është realizuar një takim dhe bashkëbisedim me të rinjtë që ishin votues për herë të parë, duke mos pasur asnjë banderol, reklamë, slogan apo lobim për të votuar forcën politike Partinë Socialiste të Shqipërisë.

III. Analiza e fakteve dhe provave



Data: 21 Shtator 2021
Nr. 451

Riçelje e hetimit administrativ ndaj kërkesës ankimore nr. 61 datë 22.7.2021 depozituar pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

Referuar nenit 77 të Kodit të Procedurave Administrative, pikat 1 dhe 2 parashikojnë se:

“1.Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

3. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.”

Referuar nenit 81, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se, “Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”.

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku të paraqitura nga palët.
- Ashtu sikurse kjo dispozitë përcakton, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi shkresën e drejtuesit të njësisë administrative nr. 10, Tiranë, e cila ka në përgjegjësi administrimin e bibliotekës “Misto Treska”, në të cilën ka mohuar jo vetëm zhvillimin e këtij aktiviteti por dhe të çdo aktiviteti të kryer për qëllime zgjedhore dhe analizoi deklaratimet e palëve në seancën dëgjimore.
- Kallëzuesi, në mbështetje të detyrimit të tij parashikuar në nenin 82 të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, nuk ka paraqitur asnjë prove shtesë.
- Kandidati për deputet z. Alfred Muharremi pohoi se aktiviteti i zhvilluar kishte natyrë informuese për të rinjtë votues për herë të parë.
- Në këto kushte, nuk u arrit të provohej se veprimtaria e zhvilluar në bibliotekën “Misto Treska”, kishte qëllim zgjedhor, por kishte karakter informues e ndërgjegjësues mbi rëndësinë e angazhimit të të rinjve në jetën publike dhe sociale. Biblioteka është një aset publik nën administrimin e Bashkisë Tiranë i cili mund të vihet në dispozicion të target grupeve të ndryshme duke zhvilluar evenimente dhe aktivitete të karakterit social, kulturor dhe informues për banorët e njësisë si dhe më gjerë. Veprimtaria e zhvilluar në bibliotekën “Misto Treska”, në datën 17 mars 2021, nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.



Data: 21 Shtator 2021
Nr. 451

Riçelje e hetimit administrativ ndaj kërkesës ankimore nr. 61 datë 22.7.2021 depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Në lidhje me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në këtë veprimtari, theksohet se, sipas pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, i cili përcakton subjektet e këtij vendimi, kryetari i bashkisë, zëvendësi dhe administrata e tij, e kanë të ndaluar, të drejtojnë të marrin pjesë, apo të kontribuojnë në çfarëdo formë në veprimtari të ndaluara, sipas këtij vendimi.

Që të jemi në shkëlqje të këtyre dy pikave të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative si kusht qëllimi zgjedhor ashtu dhe ai i drejtimit, marrjes pjesë apo kontribut i çfarëdo formë i subjektit përkatës në një veprimtari të ndaluar. Për sa kohë veprimtaria e zhvilluar nuk përbën veprimtari të ndaluar, prania e Kryetarit të Bashkisë nuk e ngarkon me përgjegjësi administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, dhe neni 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidatit për deputet z. Alfred Muharremi, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe administratorit të bibliotekës “Misto Treska”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 21 Shtator 2021
Nr. 451

Riçelje e hetimit administrativ ndaj kërkesës ankimore nr. 61 datë 22.7.2021 depozituar pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve